




GJENDJA NË UP

PROFESORËT BAHEN
KISHE PO LIGJËROJNË
E STUDENTAT
KISHE PO STUDIOJNË



GJENDJA NË UP

PROFESORËT BAHEN
KISHE PO LIGJËROJNË
E STUDENTAT
KISHE PO STUDIOJNË



Autor:

Shkelzen Gashi, OJQ Admovere

Dizajni i kopertinës dhe faqesja:

Faton Selani

Nëntor 2017

Prishtinë

Publikuar nga: Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS

Imzot Nikë Prelaj, Nr. 13, 10 000 Pristina Kosovë

Për më shumë informata: info@kfos.org www.kfos.org

Shënim: OJQ Admovere është anëtare e Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet – KITU, mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS. Ky hulumtim është pjesë e programit të KITU-së. Pikëpamjet e shprehura në këtë hulumtim janë të OJQ-së Admovere dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS

ADMOVERE (Transitional Justice | Education | Peacebuilding) angazhohet për ndërtimin e një shoqërie demokratike, promovimin e tolerancës e bashkëjetesës dhe luftimin e paragjykimeve; dialogun mes komuniteteve të ndara për t'i tejkaluar mosmarrëveshjet, si dhe promovimin e praktikave të mira për drejtësi dhe pajtim. Fushat kryesore të organizatës janë të drejtat e njeriut, me theks të veçantë të drejtësia transicionale, edukimi dhe ndërtimi i paqes. Për më shumë: <http://admovere.org/>


HYRJE

Qëllimi i këtij publikimi është t'i **identifikojë përmbledhtazi** problemet kryesore me të cilat ballafaqohet Universiteti i Prishtinës (UP) që nga paslufta e deri më sot. Për këtë janë shqyrtuar dokumente të ndryshme dhe strategji të hartuara nga UP-ja, pastaj ligjet për arsimin e lartë, të miratuara nga Kuvendi i Kosovës, raportet, analizat dhe studimet e OJQ-ve të ndryshme për UP-në, raportet e progresit të Komisionit Evropian (KE), etj.



Përzgjedhja e stafit akademik

Përzgjedhja e stafit akademik të UP-së, sidomos pas luftës në Kosovë (1998-1999), është bërë kryesisht në baza partiake/klanore/nepotiste/korruptive. Politizimi i jashtëzakonshëm i UP-së është njëra prej të metave që përmendet edhe në Raportet e Progresit të KE-së për Kosovën. Organizata ÇOHU në hulumtimin «Universiteti cullak», të publikuar në dhjetor 2013, konstatoi se një numër i konsiderueshëm i politikanëve (deputetë, ministra, zëvendës-ministra, këshilltarë politikë, drejtorë departamentesh qeveritare, etj.) ose i familjarëve të tyre janë pjesë e stafit akademik në UP. Sipas këtij hulumtimi, politikanët, me theks të veçantë ata nga PDK-ja (Partia Demokratike e Kosovës), kanë ndikuar jo vetëm në rekrutimin e stafit akademik, por edhe në zgjedhjen e organeve udhëheqëse të UP-së.



...një numër i konsiderueshëm i politikanëve (deputetë, ministra, zëvendës-ministra, këshilltarë politikë, drejtorë departamentesh qeveritare, etj.) ose i familjarëve të tyre janë pjesë e stafit akademik në UP.

Avancimet akademike

Raporti «Integriteti akademik i drejtuesve të universitetit të Prishtinës», i publikuar në shkurt 2017 nga ORCA (Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim), ka nxjerrë në pah se gati gjysma e drejtuesve të UP-së (anëtarët e Këshillit Drejtues, rektori dhe prorektorët, anëtarët e Senatit, dekanët dhe prodekanët) nuk i justifikojnë titujt e vet akademikë. Kjo do të thotë se këta pjesëtarë të stafit akademik të UP-së kanë të paktën nga një punim në revista të listuara si të dyshimta ose në publikime që s'i përmbushin kriteret e revistave të mirëfillta shkencore. Statuti i UP-së dhe Rregullorja për zgjedhjen dhe avancimin e personelit akademik parashohin kushte mjaft të lehta lidhur me kriterin më të rëndësishëm: «punime në revistë shkencore relevante ndërkombëtare apo rajonale si autor i parë ose korrespondent» të cilat përcaktojnë se profesori asistent duhet të ketë të paktën një, profesori i asocuar të paktën tri, ndërsa profesori i rregullt pesë publikime të tilla. Hulumtimi i CV-ve të profesorëve të UP-së mund të nxjerrë rezultate edhe më të këqija sesa këto të drejtuesve të UP-së.




Kryesuesi i Këshillit Drejtues të UP-së në vitin 2014 deklaroi se afro 80% e profesoratit të UP-së kanë tituj shkencorë dhe publikime pa kurrfarë vlere

Plagjiatura në punimet MA dhe PhD

Një aspekt tjetër që lidhet me mungesën e kualifikimeve të stafit akademik të UP-së është edhe plagjiatura në punimet e temave MA dhe PhD të pjesëtarëve të këtij stafi, por edhe të temave MA e PhD të mbrojtura në përgjithësi në UP. Çështja e plagjiaturës është trajtuar sipërfaqësisht dhe deri më tani nuk ka ndonjë hulumtim serioz gjithëpërfshirës për të, por indikacionet janë që plagjiatura është jashtëzakonisht e përhapur si te stafi akademik ashtu edhe te studentët në UP. Shumë shpesh, punimet e diplomave janë plagjiatura të punimeve

të paraqitura në vitet e mëparshme, e ka raste edhe kur shkruhen kundrejt një pagese të caktuar nga individë që ofrojnë këso shërbimesh përmes rrjeteve sociale dhe shpalljeve që afishohen madje edhe nëpër hapësirat e UP-së. Kryesuesi i Këshillit Drejtues të UP-së në vitin 2014 deklaroi se afro 80% e profesoratit të UP-së kanë tituj shkencorë dhe publikime pa kurrfarë vlere. Madje edhe kur zbulohen punime plagjiatë, jo që nuk jepen dorëheqje, por nuk ndërmerren as masa nga organet kompetente, e as dënim publik të veprimeve të tilla.



Plan-programet

UP ka 194 programe studimi të akredituara nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), e cila është anëtare e plotë e Asociacionit Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA). Nga këto 82 janë programe Bachelor, 86 Master dhe 26 PhD. Ekspertët vlerësojnë se AKA nuk aplikon standardet e njohura ndërkombëtarisht për cilësi në procesin e saj të akreditimit. Programet studimore janë të shkëputura nga tregu i punës. Pastaj bëhet fare pak punë praktike gjatë studimeve universitare, kryesisht

për shkak të numrit të madh të studentëve dhe planifikimit të dobët të programit mësimor. Nuk ka ndonjë hulumtim lidhur me planprogramet, madje shumë departamente të UP-së nuk i kanë planprogramet online. Duhet të hulumtohen: cilësia e planprogrameve; koordinimi i përmbajtjes së lëndëve me planprogramet; si dhe realizimi i planprogrameve. Raportet e Progresit për Kosovën të KE-së kanë sugjeruar që të reformohen planprogramet dhe të promovohet hulumtimi.

UP 194 programe studimi të akredituara

82

Bachelor

86

Master

26

PhD



Literatura dhe Bibliotekat

Në shumë departamente të UP-së studentët shpeshherë janë të shtrënguar që si literaturë të përdorin skripta dhe përmbledhje të ligjëratave, e ndonjëherë edhe teste të provimeve. Kjo lloj literature, për fat të keq, të shumtën e rasteve është pa ndonjë cilësi akademike. Për më keq, ka raste edhe kur profesorët i obligojnë studentët t'ua blejnë librat, edhe pse cilësia e tyre akademike lë mjaft për të dëshiruar. Një numër i konsiderueshëm i fakulteteve nuk kanë biblioteka, ndërsa edhe ato që kanë, i kanë dobët të furnizuara. Në shumicën e fakulteteve të UP-së, së bashku me bibliotekat e fakulteteve janë edhe sallat e leximit dhe mund të thuhet se gjendja nuk është më e mirë as në to: numri i ulëseve nëpër biblioteka dhe salla të leximit është shumë i kufizuar dhe orari i punës është shumë i shkurtër. Rreth 3 milionë € janë shpenzuar për përkthime të teksteve universitare në shqip, por shumica e këtyre teksteve gjenden nëpër depo.

Revistat akademike

Ndonëse me 13 fakultete që në vete ngërthejnë gjithsejt 41 departamente, 42 programe, 5 module dhe 5 katedra, UP-ja aktualisht boton vetëm 3 revista shkencore. Mirëpo, këto 3 revista nuk i plotësojnë kriteret ndërkombëtare, prandaj nuk kanë as kode ndërkombëtare të revistave shkencore, por vetëm kode nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës (BKUK). Pastaj, asnjëra nga njësitë akademike të UP-së nuk ka qendër kërkimore-shkencore funksionale, që do të thotë se nuk ka përkrahje financiare për hulumtime shkencore e as për botimin e revistave shkencore, ku do të mund të publikoheshin punimet eventuale shkencore. Po ashtu, pjesëtarët e stafit akademik nuk kanë motiv për të publikuar në revistat e UP-së, meqë për avancime akademike u kërkohen publikime në revista shkencore relevante ndërkombëtare ose rajonale.



Ndonëse me **13 fakultete** që në vete ngërthejnë gjithsejt **41 departamente, 42 programe, 5 module dhe 5 katedra,** UP-ja aktualisht boton vetëm **3 revista shkencore.**





Sipas të gjeturave të hulumtimit të ORCA-s, nga 1177 ligjërata sa janë monitoruar në Fakultetin Ekonomik, Filozofik dhe Juridik, 218 apo 18,5% prej tyre nuk janë mbajtur për shkak të mungesës së profesorëve.

Parapagimi në revista akademike botërore

Gjatë viteve 1970-80, UP-ja parapaguhej në një mori revistash akademike botërore. Ky parapagim, për shkak të rrethanave tashmë të njohura, u ndërpre gjatë viteve '90. Mirëpo, për fat të keq, nuk vazhdoi pas luftës në Kosovë (1998-1999), e me theks të veçantë pas Shpalljes së Pavarësisë (2008). UP-ja, për disa vjet, kishte qasje vetëm në 14 burime të ndryshme të informacioneve akademike dhe shkencore përmes platformës elektronike EBSCO. Në fund të vitit 2015, UP-ja siguroi qasje njëvjeçare në mbi 3700 revista dhe mbi 28,000 publikime të platformës prestigjioze Science Direct të Elsevier Publishing. Kjo qasje nuk u vazhdua për vitin 2017.

Prania e profesorëve në ligjërata

Shumë profesorë të UP-së mbajnë poste publike e qeveritare dhe janë të punësuar në kolegje të ndryshme private, prandaj nuk kanë kohë t'i mbajnë ligjëratat në UP. Në vend të tyre mbajtjen e ligjëratave dhe të provimeve e bëjnë asistentët e tyre. Për më keq, në vend që të ndëshkohen për mungesën, këta profesorë, siç dëshmojnë raportet e auditimit, paguhen për ligjëratat që s'i mbajnë. Gjatë muajit prill 2017, ORCA ka monitoruar mbajtjen e konsultimeve sipas orareve zyrtare në tri Fakultete me numrin më të madh të studentëve në UP: Fakultetin Filozofik, Ekonomik dhe të Juridik. Nga ky monitorim ka rezultuar se shumë profesorë kanë munguar në konsultimet që duhet t'i mbajnë gjatë orarit të punës. Sipas të gjeturave të hulumtimit të ORCA-s, nga 1177 ligjërata sa janë monitoruar në Fakultetin Ekonomik, Filozofik dhe Juridik, 218 apo 18,5% prej tyre nuk janë mbajtur për shkak të mungesës së profesorëve. Për më tej, nuk ka shqiptim të masave dhe ndalesa financiare, ashtu siç parashihet në Rregulloren për Masat Disiplinore ndaj Personelit Akademik të UP-së.

Vlerësimi i studentëve

Metodat e vlerësimit në UP i nxisin studentët të mësojnë mekanikisht (përmendësh). Studentët vlerësohen kryesisht me anë të provimeve përfundimtare, të cilat shpeshherë janë teste me zgjedhje të shumëfishta, që e nxisin të mësuarit mekanik. Kjo metodë përdoret për shkak se merr më pak kohë, e siç dihet numri i studentëve në UP është shumë i madh, gjë që e bën të vështirë vlerësimin e njohurive të tyre kreative/analitike. Për më shumë, shumica e studentëve e zgjedhin profesorin që e zhvillon testin me zgjedhje të shumëfishta e jo atë që u kërkon të shkruajnë ese. Pastaj, kopjimi është në masë të madhe i pranishëm në UP, kryesisht për shkak se shumë profesorë përdorin teste nga afatet e mëparshme të provimeve, të cilat sigurohen lehtë nëpër dyqanet për fotokopjim. Një tjetër problem është se ka pasur raportime për profesorë dorëshirë në vlerësim, kjo ngaqë synojnë ta blejnë heshtjen e studentëve për shkak të paaftësisë për të ligjëruar dhe mungesave në ligjërata. Profesorët që janë edhe politikanë kështu synojnë të fitojnë vota nga studentët. Por, ka raste edhe të sjelljeve mospërfillëse, nënçmuese, fyese e kërcënuese të profesorëve kundrejt studentëve.

Ngacmimi Seksual

Qendra për Art dhe Komunitet - Artpolis në fillim të vitit 2017 publikoi një raport të titulluar «Trajtimi i Ngacmimit Seksual në Universitetet Publike», po theksi vihet në masë të madhe te UP-ja, si universiteti më i madh publik në vend. Ky raport pretendon se ngacmimi seksual është i përhapur – nuk ka të dhëna për shkallën e përhapjes – por nuk raportohet pothuajse fare, e kur raportohet në ndonjë rast, nuk ndërmerret pothuajse asgjë. Sipas këtij raporti, studentet nuk i raportojnë rastet e ngacmimit seksual sepse, përveçqë nuk besojnë se do të ndërmerret gjë, kanë frikë edhe nga pasojat e mundshme, por edhe nga turpi publik. UP në 2013 ka përcaktuar një grup rregullash në Kodin e Etikës për Personelin Akademik, duke paraparë trajtimin e rasteve të ngacmimit seksual, por nuk ofrohen të drejta dhe detyrime specifike edhe për stafin administrativ a studentët e UP-së. Pra, nuk ka politika të hartuara specifikisht për rastet e ngacmimit seksual, përkufizime të qarta se cilat forma të sjelljes përbëjnë ngacmim seksual, shpjegime të procedurave të raportimit, për t'i inkurajuar studentët që t'i raportojnë rastet, e as përcaktim të procedurave që duhet të ndiqen nga stafi akademik dhe administrativ pasi të raportohen rastet dhe të fillojnë procedurat.

Vlerësimi i performancës së profesorëve

Sa i takon vlerësimin të profesorëve, mungon jo vetëm vlerësimi nga ana e studentëve, por edhe nga dekanati/rektorati. Për më shumë, përveç vlerësimin që bëhet nga Agjencia e Kosovës për Akreditim si pjese e procesit të akreditimit, nuk ka kurrfarë vlerësimi për punën e UP-së nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) / Qeveria e Kosovës, si donator kryesor i UP-së (gati 30 milionë € për vitin 2017), e as nga Komisioni Parlamentar për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport / Kuvendi i Kosovës, si themelues i UP-së.

**QEVERIA E KOSOVËS,
SI DONATOR
KRYESTOR I UP-SË**

**30 milionë €
PËR VITIN 2017, NUK
KA KURRFARË VLERËSIMI
PËR PUNËN E SAJ.**




Raporti profesorë-studentë

UP me 48,735 studentë, ka 924 pjesëtarë të personelit të rregullt akademik (mësimdhënës dhe asistentë). Veç kësaj, UP çdo vit angazhon 479 mësimdhënës me orar jo të plotë. Raporti profesor-student është afërsisht 1:50 (Shqipëri 1:24, Serbi 1:23, Maqedoni 1:17, dhe Kroaci 1:9). Pagat mujore për mësimdhënësit e rregullt janë ndër më të mirat në rajon - prej 700 – 1,400 €, duke ua shtuar këtyre pagesat për orët shtesë, mbajtjen e provimeve, mbikëqyrjen e punimeve në Bachelor, Master, PhD dhe pjesëmarrjen nëpër komisione të ndryshme. Përveç kësaj, shumë profesorë japin mësim edhe në universitete të tjera publike ose private, gjë që ndikon dukshëm në cilësinë e përmbushjes së detyrave të tyre në UP.



48,735 studentë



924 pjesëtarë të personelit të rregullt akademik (mësimdhënës dhe asistentë)

Raporti student-infrastrukturë

Klasët janë të stërm bushura me studentë, pra numri i studentëve është në shpërputhje me hapësirën. Sipas të dhënave të Rektoratit, UP-ja ka gjithsej 86.116.00 m², që kur pjesëtohet me numrin e tërësishëm të studentëve që është 48.735, del se në UP për një student ka 1.77 m², që është nën standardet e arsimit fillor e të mos


flasim për atë universitar. Rastet më ekstreme nga të gjitha fakultet e UP-së janë Fakulteti Juridik dhe Fakulteti Ekonomik me 11.925 m² e me 17.834 studentë, që i bie 0.67 m² për student, pastaj Fakulteti i Arteve me 7.151.00 m² e me 935 studentë, që do të thotë 7.65 m² për student.

Numri i studentëve është në shpërputhje me hapësirën.

86.116.00 m²

që kur pjesëtohet me numrin e tërësishëm të studentëve që është

48.735 student



Organizatrat studentore

Nga të dhënat e hulumtimeve të realizuara nga BIRN-i në vitin 2009 dhe nga D4D në vitin 2015 dilte se rreth $\frac{3}{4}$ e studentëve të UP-së nuk ishin të kënaqur me organizatat studentore. Që nga paslufta në Kosovë (1998-1999), këto organizata nuk kanë pasur pothuajse asnjë projekt për ngritjen profesionale e shkencore të studentëve. Ato kryesisht janë marrë me organizimin e ekskursioneve, brucoshiadave e absolventiadave (madje, për këto organizime janë akuzuar nga studentët se kanë keqpërdorur), ose me aktivitete jashtë kompetencave të tyre e që u shërbejnë ekskluzivisht partive politike (p.sh. protestat kundër aktakuzave ose dënimeve të ish-pjesëtarëve të UÇK-së për krime). Organizatat studentore angazhoheshin ekskluzivisht në aktivitete politike edhe gjatë viteve '70 e '80 (Lidhja e Rinisë Socialiste - LRS) dhe gjatë viteve '90 (Unioni i Pavarur i Studentëve - UPS). Madje, ka pasur raste kur liderë studentorë ishin përfshirë në ndërmjetësim të paligjshëm në provime dhe në regjistrim të studentëve të rinj. Në vend se të jenë gjeneratorë të reformave në UP, duke qenë, mes tjerash, faktorë me rëndësi në zgjedhjet

për dekanët, Rektorin dhe Këshillin Drejtues, këto organizata janë kujdesur që në këto pozita të zgjedheshin profesorë të lidhur me politikën e të papërgatitur profesionalisht. Jo rastësisht, shumë liderë të organizatave studentore, falë shërbimeve që ua kanë bërë partive politike, sot kanë pozita të rëndësishme në institucionet e Kosovës. Shumica e studentëve, duke mos pasur besim tek përfaqësuesit e tyre, kryesisht heshtin kur ballafaqohen me probleme e parregullsi. Edhe interesimi i studentëve për të marrë pjesë në zgjedhjen e përfaqësuesve të tyre është jashtëzakonisht i ulët. Prandaj, nuk ka llogaridhënie nga liderët studentorë, të cilët i shërbejnë një grupi të vogël klientelist dhe neglizhojnë nevojat e studentëve. Edhe mënyra e zgjedhjes / forma e përfaqësimit ka bërë që shumë departamente të mos kenë fare përfaqësues në Këshillin e Studentëve / Parlamentin e Studentëve. Po ashtu, zakonisht përfaqësues të studentëve zgjidhen studentët e dobët. Duhet thënë edhe se, udhëheqësitë e këtyre organizatave janë pothuajse të gjithë djem.

Minoritetet në UP

Në vitet e para të pasluftës në Kosovë (1998-1999) për arsye të shumta ishte i pamundshëm integrimi i minoriteteve në UP, e sidomos i minoritetit serb. Mirëpo, pas Shpalljes së Pavarësisë (2008), Kosova ka pasur më shumë mundësi që – meqë synon të jetë pjesë e integritimeve evropiane dhe e Procesit të Bolonjës – të ofrojë arsim të lartë në gjuhët e minoriteteve, në radhë të parë në gjuhët sllave, por edhe në gjuhët e minoriteteve të tjera. Në vitin 2006 «Forumi 2015» ka publikuar një broshurë me disa shembuj të praktikës së mirë nga vende të BE-së për plotësimin e nevojave të grupeve minoritare për

arsim të lartë. Pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, UP-ja ka filluar të regjistrojë studentë minoritarë: boshnjakë, romë, ashkalinj, egjiptianë dhe turq. Kuotat për pranimin e studentëve minoritarë kanë shkuar duke u rritur për çdo vit. Në vitin akademik 2016-2017 kuota ishte 12% (rreth 1 mijë studentë minoritarë). Duhet thënë se institucionet e Kosovës kanë qenë të gatshme ta përkrahin procesin e integritimit edhe të minoritetit serb në arsimin e lartë në Kosovë, mirëpo institucionet arsimore që zhvillojnë punën në gjuhën serbe kanë refuzuar çfarëdo bashkëpunimi me institucionet e Kosovës.



Kuotat për pranimin e studentëve minoritarë kanë shkuar duke u rritur për çdo vit. Në vitin akademik 2016-2017 kuota ishte

12% (rreth 1 mijë studentë minoritarë).

PËRFUNDIM

Nga shqyrtimi i materialeve të lartpërmendura, rezulton se UP-ja ballafaqohet me këto probleme: staf akademik të pakualifikuar; përzgjedhje të stafit akademik në baza partiake / klanore / nepotiste / korruptive; avancime të pamërituara akademike; plagjiaturë; mungesë të plan-programeve koherente dhe të lidhura me nevojat e ekonomisë e shoqërisë në përgjithësi; mungesë të revistave shken-

core; mosparapagim në revista shkencore ndërkombëtare; mungesë të bibliotekave; literaturë obligative të demoduar për studentët; mungesë të vlerësimit të profesorëve nga studentët dhe vlerësim i studentëve nga profesorët me metoda të demoduara; numër të studentëve në shpërputhje me numrin e profesorëve dhe me hapësirën fizike; organizatat studentore të politizuara, e me radhë.



Bibliografia

1. Kosovo Initiative for Democratic Society (KIDS) «E ardhmja në bast – studim mbi arsimin e lartë në Kosovë», Prishtinë, 2002.
2. Center for European Integration Studies «Arsimi i Lartë Ligjor në Shtetet dhe Territoret e Ish-Jugosllavisë – pengesë në promovimin e sundimit të së drejtës në Ballkanin Perëndimor», Bonn, 2003.
3. Forumi 2015 & Kosovo Education Centre (KEC) «Arsimi i lartë për minoritetet në Kosovë» Prishtinë, 2006.
4. Balkan Investigative Reporting Network (BIRN) «Gjendja dhe Problemet në Universitetin e Prishtinës – raport analitik i hulumtimit mbi problemet dhe cilësinë e studimeve në Universitetin e Prishtinës», Prishtinë, 2009.
5. Democracy for Development (D4D) «Reformimi i Universitetit të Prishtinës – mision i mundshëm?», Prishtinë, 2015.
6. Democracy for Development (D4D) «Nxitje për llogaridhënie dhe performancë më të mirë në Arsimin e Lartë», Prishtinë, 2016.
7. Organizata ÇOHU «Udha e Shkronjave», Prishtinë, 2017.
8. Organizata ÇOHU «Udha e Shkronjave», Prishtinë, 2017.
9. Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA) «Integriteti Akademik i Drejtuesve të Universitetit të Prishtinës», Prishtinë, 2017.
10. Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA) «Dembelët e Hasan Prishtinës I», Prishtinë, 2017.
11. Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA) «Dembelët e Hasan Prishtinës II», Prishtinë, 2017.
12. Qendra për Art dhe Komunitet - Artpolis «Trajtimi i Ngacmimit Seksual në Universitete Publike», Prishtinë, 2017.
13. Raportet e Progresit të Komisionit Europian 2005-2016.



Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo